



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:149558
Datë: 26.04.2024
Numri i dokumentit: 05625726

Ac.nr.2985/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Besnik Bislimaj kryetar i kolegjit, Faton Ademi dhe Hidajete Gashi Alaj, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit F. M. nga fshati D. Komuna e Deqanit te cilit më autorizim i përfaqëson Avokati I. S. nga Prishtina kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve Sigal Uniqa Group Austria, Rr. “ P. V.” pn. Prishtine, te cilin më autorizim e ka përfaqësuar përfaqësuesi A. N. nga Prishtina, për shkak të kompensimit të dëmit material dhe jomaterial, duke vendosur lidhur me ankesat e të paditurës të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë, Dega në Deçan, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.85/2019 datë 30.11.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 22.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PJESËRISHT refuzohet e pa themelta ankesat e të paditurës Kompania e Sigurimeve “Sigal” me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë, Dega në Deçan, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.85/2019 datë 30.11.2021, në pikën I, II sa i përket dëmit material dhe jo material, si dhe pika III, VËRTETOHET.

PJESËRISHT aprovohet si e themeltë ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve “Sigal” me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë, Dega në Deçan, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.85/2019 datë 30.11.202, sa i përket kamatës ndryshohet dhe tani gjykohet si në Vijim: Detyrohet e paditura se shumata e gjykuara për dëmin material dhe jo material në shumë të përgjithshme prej 1,800.00 euro, ti paguaj me kamatë si për mjetet e deponuara në Bankat afariste të Kosovë, pa debitimin të caktuar për një vit, duke filluar nga data e nxjerrjes së aktgjykimit të ankimuar me datë 30.11.2021, deri në pagesën definitive.

Pika IV e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë, Dega në Deçan, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.85/2019 datë 30.11.202, mbetet e pa shqyrtuar.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.85/2019 datë 30.11.2021, ka vendosur: LAPROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit F. M. nga fshati Dubrav Komuna e Deçanit te cilit më autorizim i përfaqëson Avokati I. S. nga Prishtina.

II. DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve Kompania e Sigurimeve Sigal Uniqa Group Austria, Rruga “P.V.” pn. Prishtine të zhdëmtimit të demit jo material dhe material sipas bazës të auto-përgjegjesisë të aksidentit të komunikacionit të ndodhur më datën 26.11.2010 në fshatin P. Komuna e Deçanit, tija paguan shumën e përgjithshme prej 1800.00 euro, më kamat prej 8% nga dita e përpilimit të aktgjykimit me datën 30.11.2021, e gjeri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes të këtij aktgjykimi e nën kërcënim të përmbarrimit dhe atë :

Në emër të demit jo material

Për dhimbje të përjetuar fizike për te gjitha llojet intensitetit shumën prej -----1000 euro
Për shkak frikës të përjetuar shumën prej -----500 euro
Në shumë të përgjithshme prej ----- 1500 euro

Në emër të demit material

Në emër të ndihmës dhe kujdesit te huaj shumën prej-----150 euro
Ne emër te ushqimit te përforcuar shumën prej -----150 euro
Në shumë të përgjithshme prej ----- 300 euro

III. DETYROHET e paditura qe paditësit ne emër të shpenzimeve procedurës kontestimore tija paguaj shumën prej 913.00 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij aktgjykimi e nën kërcënim të përmbarrimit .

IV. Refuzohet kërkesëpadia paditësit F. M. nga fshati D. Komuna e Deçanit qe e paditura Kompania e Sigurimeve Sigal Uniqa Group Austria Rruga P. V. pn te ja kompensojë dhe atë:

Në emër të demit jo material

Për dhimbje të përjetuar fizike për te gjitha llojet intensitetit shumën prej -----5000 euro
Për shkak frikës të përjetuar shumën prej -----2500 euro
Në shumë të përgjithshme prej ----- 7500 euro

Në emër të demit material

Në emër të ndihmës dhe kujdesit te huaj shumën prej-----150 euro
Ne emër te ushqimit te përforcuar shumën prej -----150 euro
Në shumë të përgjithshme prej ----- 300 euro

Kundër këtij aktgjykimi, e paditura, Kompania e Sigurimeve “Sigal” me seli në Prishtinë, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë ta aprovoj ankesën si të bazuar, ta prishë aktgjykimin a ankimuar dhe lëndën ta kthen në gjykatën e shkallë së parë në ri procedurë dhe ri vendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka parashtruar paditësi.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, si dhe shikimin, analizimin dhe vlerësimin shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi F. M. nga fshati D., Komuna e Deçanit, me datën 16.11.2012, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi për kompensim dëmit material dhe jo material, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Sigal” me seli në Prishtinë, i cili kërkesë, e ka precizuar në seancën e datës 11.07.2013, duke kërkuar konkretisht si në precizimin e kërkesë padisë.

Gjykata e shkallës së parë, duke vendosur sipas padisë së paditësit, pas mbajtjes së seancës për shqyrtim kryesor, dëgjimit të palëve ndërgjyqëse dhe administrimit të provave, ka marrë aktgjykimin C.nr.185/2012 të datës 19.07.2013, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur konkretisht si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Kundër këtij aktgjykimi, e paditura, Kompania e Sigurimeve “Sigal” me seli në Prishtinë, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë ta aprovoj ankesën si të bazuar, ta prishë aktgjykimin a ankimuar dhe lëndën ta kthen në gjykatën e shkallë së parë në ri procedurë dhe ri vendosje.

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktvendimin AC.nr. 1882/2014 të datës 28.03.2019, ka aprovuar ankesën e të paditurës si të bazuar dhe e ka prishur aktgjykimin e ankimuar C.nr.185/2012 të datës 19.07.2013 dhe lënda është kthyer në gjykatën e shkallës së parë në ri procedurë dhe ri vendosje.

Në ri procedurë, Gjykata e shkallës së parë, pas mbajtjes së seancës për shqyrtim kryesor, dëgjimit të palëve ndërgjyqëse dhe administrimit të provave, ka marrë aktgjykimin e ankimuar C.nr.85/2019 të datës 30.11.2021, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur konkretisht si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Gjykata e shkallës së parë, në aktgjykimin e ankimuar ka arsyetuar se: Pas konstatimeve të mjekëve, ekspert Ortopedisë dhe Psikiatrisë të dhëna si me lartë pas leximit të raporteve mjekësorë që gjenden në shkresat e lëndës dhe ekzaminimit të paditësit drejt për se drejt në seance të shqyrtimit kryesor se paditësi si pasojë e shkaktimit të aksidentit ka pësuar lëndime trupore që karakterizohen si lëndime të lehta trupore. Që gjykata me rastin e përcaktimit të lartësisë së dëmit gjykata ka pasur konsiderate të gjitha rrethanat të cilat kanë ndikuar në

përcaktimin e tij si intensitetit e dhimbjeve fizike kohëzgjatjen e tyre dhe friken e pësuar dhe ka gjetur se shumata e përcaktuara për shpërblimin e paditësit do të ofrojnë satisfaksion të duhur për dhembjet e përjetuara dhe se do të ndikojnë në vënien e baraspeshës psikike dhe emocionale të paditësit.

Më tej ka arsyetuar se: Pasi që gjykata që bëri vlerësimin e provave veç e veç dhe atyre bashkërisht dhe nga kjo gjendje e vërtetuar faktike si me lart erdhi në përfundim dhe vërtetoi në mënyrë të pa dyshimtë se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar në kuptim të neneve: 136,137, 140,155, 159 dhe neni 183 të Ligjit Nr .04L/-077 për marrëdhëniet e detyrimeve të Kosovës duke vendosur si në pikën I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimit.

Vendimi mbi kamatën e gjykuar është marrë në kuptim të nenit 382.2 të LMD-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në kuptim të nenit 449, 452 dhe 463 të LPK-së.

Gjykata e Apelit, nisur nga kjo gjendje e çështjes pajtohet me pikëpamjet juridike të gjykatës së shkallës së parë pasi që përfundimi i saj është i rregullt dhe i ligjshëm për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, e gjithashtu nuk përmban shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, ndërsa pjesërisht në mënyrë të gabuar është zbatuar e drejta materiale, për të cilat shkaqë Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit aktgjykimi i shkallës së parë, nuk është i përfshirë me të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet dhe në lidhshmëri me këtë dispozitiv i aktgjykimit është i qartë dhe i përmbarueshëm dhe përmban arsye për të gjitha faktet vendimtare të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë e sipas të cilave edhe është vendosë lidhur me themelësinë e kërkesëpadisë. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre.

Gjykata e Apelit vlerëson se nga shkresat e lëndës konstatohet se të gjitha faktet e çështjes janë provuar me prova përkatëse të cilat janë administruar në një proces të rregullt gjyqësor. Përgjegjësia e të paditurës për kompensimin e dëmit në lartësinë e përgjegjësisë së të siguarit të tyre nuk është kontestuar vazhdimisht nga e paditura e që është vërtetuar edhe nga provat që janë administruar në këtë çështje kontestimore si dhe lartësia e kërkesës është vërtetuar nga ekspertizat mjekësore që gjenden në shkresat e lëndës. Gjendjen faktike për dëmin jo material dhe material, për paditësin, gjykata e shkallës së parë e ka provuar përmes mendimit të ekspertit mjeko-ligjor, Dr. A. T., Ortoped - traumatolog dhe Dr. Sh. P., Psikiatër për të gjitha kategoritë e dëmit jo-material duke u bazuar edhe në vlerësim të lirë nga ana e gjykatës së shkallës së parë, mendimet e ekspertëve mjeko-ligjor i ka vlerësuar si profesionale, gjithëpërfshirëse dhe reale, duke pas parasysh natyrën e lëndimit, kohëzgjatjen e dhimbjeve, frikën e përjetuar etj., dhe se kompensimi i dëmit jo-material dhe material në të holla ka për qëllim satisfaksionin për të dëmtuarin dhe jo që të arrihet ndonjë qëllim tjetër shoqëror i këtij kompensimi. Gjykata e shkallës së parë, ka dhënë shpjegimet e duhura në arsyetim të aktgjykimit, për shumata e gjykuara

sipas kategorive të dëmit si përfundim e ka marrë për bazë mendimin e ekspertëve mjekësore, prandaj, Gjykata e Apelit vlerëson se shumata e aprovuara për dëmin jo materiale dhe material, janë në përputhje edhe me lëndimet e shkaktuara paditëses dhe të njëjtat paraqesin satisfaksion në raport me lëndimet e marra, intensitetin e dhimbjeve dhe të frikës, kohëzgjatjen e tyre si dhe kohën e nevojshme për shërimin e tyre e të cilat janë konstatuar edhe nga ekspertizat e ekspertëve mjeko-ligjor, Dr. A. T., Ortoped - traumatolog dhe Dr. Sh. P., Psikiatër. Në çdo rast për dëmin jo material, gjykata duhet të ketë në konsideratë rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe qëllimit të cilit i shërben ky kompensim, duke u kujdesur që kompensimi tu shkoj përshtati qëllimeve që synohen me kompensimin e dëmit jo material e që është satisfaksion për të dëmtuarin.

Gjykata e Apelit nuk i morri për bazë pretendimet e të paditurës në lidhje me aplikim të gabuar të së drejtës materiale sa i përket dëmit jo material, pasi që gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale kur është bazuar në nenin Neni nenit 154.1 të LMD-së së vitit 1978, i cili ligje ka qenë në fuqi në kohën e shkakimit të aksidentit, e i cili parasheh që “*kush i shkakton tjetrit dëmin, ka për detyrë të ia kompensoi, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij*”, kurse me dispozitën e nenit 195 par.1 i këtij ligji përcakton se “*Kush i shkakton tjetrit lëndim trupor ose ia dëmton shëndetin ka për detyrë të shpërblejë shpenzimet rreth mjekimit dhe shpenzimet tjera të nevojshme lidhur me këtë,...*”. Të nenit 200 të po këtij ligji i cili përcakton se “*Për dhimbjet e pësuar fizike, për dhimbjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor..., do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla...*”. ndërsa par. 2 përcakton “*Me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit jomaterial, si dhe mbi shumën e kompensimit të tij, gjykata merr parasysh rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky kompensim, e gjithashtu edhe për faktin se më të mos u shkoj përshtat synimeve që nuk janë të përshtatshme me natyrën e saj...*”. Andaj, gjykata e shkallës së parë është bazuar në dispozitat materialo-juridike të cilave u është referuar e në përputhje me gjendjen faktike, duke marrë në konsideratë natyrën e lëndimeve, dhe rrethanat tjera që ndikojnë në përcaktimin e lartësisë së kompensimit siç janë natyra dhe kohëzgjatja e dhimbjeve fizike, lloji, intensiteti dhe kohëzgjatja e frikës, rrethanat tjera, e sidomos moshën e paditësit si dhe praktika gjyqësore të cilat rezultojnë se shumata e gjykuara janë në përputhje me qëllimin shoqëror për kompensimin e dëmit. Gjykata ka vendosur në mënyrë të ekuilibruar në mes të shumave të gjykuara dhe natyrës së lëndimeve përkatësisht dëmeve që ka pësuar paditësit, duke siguruar që kompensimi i gjykuar të jetë satisfaksion për paditësit, duke shmangur qëllimet tjera materiale që mund të bien ndesh me qëllimin e satisfaksionit.

Përveç kësaj Gjykata e Apelit e mbështet vendimin e gjykatës së shkallës së parë përkitazi me kërkesëpadinë e paditëses sa i përket dëmit material për ushqim të përforcuar, dhe ndihmën e personit të tretë, pasi që ky lloj kompensimi i gjykuar sipas aktgjykimit të ankimuar është në harmoni me rrethanat e tjera të krijuara si dhe me vlerësimin e ekspertëve mjekësor, të cilët kanë konstatuar se për paditësin ka qenë e nevojshme ushqimi i përforcuar për 15 ditë, ndihma e personit të tretë në kohëzgjatje prej 15 ditë, dëme ky që është i mbështetur edhe në provat materiale që gjinden në shkresat e lëndës si dhe nevojat e paditëses të përcaktuara nga ekspertët e cekur si më lartë.

Gjykata e Apelit analizojë pretendimet ankimore të të paditurës në lidhje me shkeljet e dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par. 2 pika o) e LPK-së, në lidhje me tejkalimin e kërkesë padisë së paditësit nga ana e gjykatës së shkallës së parë, por të njëjtat pretendime nuk u morën për bazë pasi që gjykata e shkallës së parë sipas aktgjyqimit të ankimuar nuk ka bërë tejkalim të kërkesë padisë së paditësit sepse duke shikuar në shkresat e lëndës konstatohet se paditësi në precizimin e kërkesë padisë së tij ka kërkuar edhe dëmin material për ndihmën e personit të tretë në lartësi prej 300 euro si dhe ushqim i përforcuar në lartësinë prej 300 euro dhe se fakti që gjykata e shkallës së parë në procedurën e vendosjes sipas aktgjyqimit C.nr. 185/2012 të datës 19.07.2013 nuk është vendosur në këto kërkesa, i njëjti aktgjykim është prishur në tërësi dhe çështja është kthyer në ri vendosjen shkallën e parë dhe se paditësi në ri vendosje ka qëndruar në tërësi pranë padisë dhe kërkesë padisë së precizuar që nënkupton se i njëjti ka qëndruar edhe pranë kërkesës për kompensimin e dëmit material për këto kategori të dëmit. Andaj, në rastin konkret nuk mund të flitet për tejkalim të kërkesë padisë së paditësit, pasi që edhe në ri procedurë kjo kërkesë ka ekzistuar.

Gjykatës së Apelit të Kosovës i rezultuan të bazuara pretendimet ankimore të të paditurës në lidhje me kamatën e gjykuar nga gjykata e shkallës së parë, ashtu që gjykata e Apelit duke vepruar sipas kësaj ankese, ka ndryshuar aktgjykimin e ankimuar sa i përket ankesës dhe se vendimin e sajë si në dispozitiv nën II të këtij aktgjykimi e mbështet në kuptim të nenit 277 të LMD-së së vitit 1978 pasi që në kohën e shkaktimit të aksidentit, ky ligje ka qenë në fuqi dhe në këtë rast nuk mund të zbatohet dispozitat e LMD-së së ri të vitit 2012 siç ka zbatuar gjykata e shkallës së parë kur është bazuar në nenin 382 të LMD-së.

Sa i përket vendimit për shpenzimet procedurale të gjykuara nga gjykata e shkallës së parë, edhe gjykata e Apelit e përkrah një vendim të tillë pasi që shpenzimet e aprovuara janë shpenzime në përputhshmëri të plotë me veprimet procedurale, pasi që janë veprime të domosdoshme, e gjithashtu duke pas parasysh edhe suksesin e paditësve në procedurë dhe atë në kuptim të nenit 452.1 të LPK-së.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore, por Gjykata e Apelit, nuk ka gjetur se aktgjykimin i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Gjykata e Apelit, vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, në kuptim të nenit 194 të LPK-së, duke mos e shqyrtuar pikën IV të dispozitivit të aktgjyqimit të ankimuar, pasi që për të njëjtin nuk kishte pretendime ankimore.

Nga arsyet e cekura më lartë, Gjykata e Apelit në bazë të nenit nenin 194 dhe 195 par. 1 pika d), të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - PRISHTINË
AC.nr. 2985/2022, me datë 22.04.2024

Kryetar i kolegjit, Gjyqtari
Besnik Bislimaj, d.v